LIGJ
Nr.8763, datë 2.4.2001

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7908, DATË 5.4.1995,
"PËR PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën" bëhet kjo shtesë:

Pas pikës 6 të nenit 27 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

"Sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira subjekteve juridike e fizike, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me synim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Procedurat dhe vlerat e qirasë, sipas kategorive ujore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për miratimin e sipërfaqeve ujore, të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, për dhënien me qira për qëllimin e mësipërm, të merret edhe mendimi i Komitetit të Zhvillimit të Turizimit, i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Ujit."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2968, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani